



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:232584  
Datë: 29.02.2024  
Numri i dokumentit: 05392337

**C. nr. 3546/2023**

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Atdhe Berisha, në çështjen juridike kontestimore të paditësve B.G.B., B.B., E.U., E.B. dhe E.A. që të gjithë nga Prizreni të cilët me autorizim i përfaqëson avokat A.H. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, të cilën e përfaqëson V.I.Xh. me objekt të padisë kompensimi i shujtave, jashtë shqyrtimit kryesor, me datë 29.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

**I.** APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësve B.G.B., B.B., E.U., E.B. dhe E.A. që të gjithë nga Prizreni, DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, që paditësve të i kompensoj në emër të shujtave ditore:

- Paditëses B.G.B. në emër të shujtave ditore për 120 ditë pune të realizuara në vitin 2022 (respektivisht për periudhën prej datës 01.01.2022 e deri më 20.11.2022), t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 240.00 euro;
- Paditësit B.b. në emër të shujtave ditore për 120 ditë pune të realizuara në vitin 2022 (respektivisht për periudhën prej datës 01.01.2022 e deri më 20.11.2022), t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 240.00 euro;
- Paditësit E.U. në emër të shujtave ditore për 120 ditë pune të realizuara në vitin 2022 (respektivisht për periudhën prej datës 01.01.2022 e deri më 20.11.2022), t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 240.00 euro;
- Paditësit E.B. në emër të shujtave ditore për 237 ditë pune të realizuara në vitin 2020 dhe 2022 (respektivisht për periudhën prej datës 01.01.2020 e deri më 20.11.2022), t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 474.00 euro;
- Paditësit E.A. në emër të shujtave ditore për 135 ditë pune të realizuara në vitin 2022 (respektivisht për periudhën prej datës 01.01.2022 e deri më 20.11.2022), t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 270.00 euro.

**II.** DETYROHET e paditura Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren që paditësve t'ia paguaj kamatën në lartësi prej 8%, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 31.10.2023, e deri në

pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 342.00 euro, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit, e nën kërcenim të përmbarimit të detyrueshëm.

### A r s y e t i m

Paditësit B.G.B., B.B., E.U., E.B. dhe E.A. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tyre, pranë kësaj gjykate me datën 31.10.2023 kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, me objekt të padisë kompensimin e shujtave.

Të autorizuarit e paditësve në padi kanë theksuar se paditësve ju takon kompensimi për shujtat ditore për vitin 2020 dhe 2022, nga 2 euro në ditë për çdo ditë pune, sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së paditësve drejtuar të paditurës për kompensimin e shujtave për vitin 2020 dhe 2022, e paditura nuk e ka paguar shumën dhe nuk është përgjigjur fare në kërkesë. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësve vullnetarisht, i ka propozuar gjykatës që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i kanë kërkuar.

E paditura, përmes përfaqësueses ligjore të komunës në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, lidhur me kompensimin e shujtës ditore. Ka theksuar se bazuar në njoftimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me numër 01B/488 të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021, padia dhe kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar. Po ashtu sipas të autorizuarit të të paditurës përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësja nuk ka ofruar ndonjë provë që është anëtarë i sindikatës. Po ashtu ka theksuar se të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-193. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditësit është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e saj. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadija e paditësve është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësit B.G.B., B.B., E.U., E.B. dhe E.A. janë në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht mësimdhënëse në SHMLM “Lorenc Antoni” në Prizren.

Nga vërtetimi nr.145/12/2023 i datës 20.09.2023, i lëshuar nga drejtori i shkollës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja B.G.B. nga Prizreni është në marrëdhënie pune-mësimdhënëse pranë SHMLM “Lorenc Antoni” në Prizren dhe e njëjta në vitin 2022 për periudhën nga data 01.01.2022 e deri më 20.11.2022 ka punuar gjithsej 120 ditë pune.

Nga vërtetimi nr.145/13/2023 i datës 20.09.2023, i lëshuar nga drejtori i shkollës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi B.B. nga Prizreni është në marrëdhënie pune-mësimdhënëse pranë SHMLM “Lorenc Antoni” në Prizren dhe i njëjti në vitin 2022 për periudhën nga data 01.01.2022 e deri më 20.11.2022 ka punuar gjithsej 120 ditë pune.

Nga vërtetimi nr.145/14/2023 i datës 20.09.2023, i lëshuar nga drejtori i shkollës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi E.U. nga Prizreni është në marrëdhënie pune-mësimdhënëse pranë SHMLM “Lorenc Antoni” në Prizren dhe i njëjti në vitin 2022 për periudhën nga data 01.01.2022 e deri më 20.11.2022 ka punuar gjithsej 120 ditë pune.

Nga vërtetimi nr.09-22/2021 i datës 18.01.2021, i lëshuar nga drejtori i shkollës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi E.B. nga Prizreni është në marrëdhënie pune-mësimdhënëse pranë SHMLM “Lorenc Antoni” në Prizren dhe i njëjti në vitin 2020 për periudhën nga data 01.01.2020 e deri më 31.12.2020 ka punuar gjithsej 117 ditë pune, ndërsa nga vërtetimi nr.145/15/2023 i datës 20.09.2023, i lëshuar nga drejtori i shkollës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi Elvis Bytyqi nga Prizreni është në marrëdhënie pune-mësimdhënëse pranë SHMLM “Lorenc Antoni” në Prizren dhe i njëjti në vitin 2022 për periudhën nga data 01.01.2022 e deri më 20.11.2022 ka punuar gjithsej 120 ditë pune.

Nga vërtetimi nr.145/16/2023 i datës 20.09.2023, i lëshuar nga drejtori i shkollës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi E.A. nga Prizreni është në marrëdhënie pune-mësimdhënëse pranë SHMLM “Lorenc Antoni” në Prizren dhe i njëjti në vitin 2022 për periudhën nga data 01.01.2022 e deri më 20.11.2022 ka punuar gjithsej 135 ditë pune.

Vërtetimet e lartcekura, Gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, të cilës gjykata ia fali besimin e plotë pasi që e njëjta është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat si të tillë janë të pranueshëm edhe për vetë palën e paditur.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.01/B, nr. prot. 105, e dt.22.01.2021, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Me nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.01B, nr. prot. 105, e datës 22.01.2021 është përcaktuar e drejta e punëtorëve në kompensimin e shujtave dhe atë “*Të punësuarve (antarë të SBAShK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...*”.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: “*Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar*

*seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 134 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.*”, pasi që e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si punëtores e arsimit-mësimdhënëse, t’ia paguaj kompensimin e shujtave, konform detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit me numër 01/B, numër të prot. 105 e datës 22.01.2021, neni 35 paragrafi 7, pasi që për paditëset B.G.B., B.B., E.U., E.B. dhe E.A. kërkesa është bërë e arritshme për 120 ditë pune për vitin 2022, apo shuma e përgjithshme prej 240,00 euro për secilin, ndërsa për paditësin E.B. kërkesa është bërë e arritshme për 337 ditë pune për vitin 2020 dhe 2022, apo shuma e përgjithshme prej 474,00 euro dhe për paditësin E.A. kërkesa është bërë e arritshme për 135 ditë pune për vitin 2022, apo shuma e përgjithshme prej 270,00 euro

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (31.10.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 312 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 30 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 342.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
C.nr.3546/23, datë 29.02.2024

G j y q t a r i  
Atdhe Berisha

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.